



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001237/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandohet respektimi i legjislacionit që ka të bëjë me procedurat për shoqërimin ose paraqitjen e shtetasve në ambientet e Policisë së Shtetit, si dhe plotësimi me saktësi i regjistrave dhe procesverbaleve që mbahen në këto raste.*

**DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Tiranë**

**KOMISARIATIT TË POLICISË NR.2
Tiranë**

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi T. A., i cili pretendon se është mbajtur 9 orë në dhomat e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Nr.2, Tiranë megjithëse është thirrur nga vetë punonjësit e policisë për të dhënë sqarime lidhur me një kallëzim të bërë ndaj tij. Gjithashtu, avokati i tij nuk është lejuar të jetë i pranishëm gjatë dhënies së deklarimeve, si dhe nuk i është dhënë një kopje e procesverbalit të deklarimeve të bëra para punonjësve të policisë.

Më konkretisht, ankuesi shpjegon se punon si administrator i një shoqërie administratorësh të pallateve. Në datën 17.10.2019, rreth orës 10:30, është kontaktuar në telefon nga specialisti i policisë së zonës D. L., i cili i ka kërkuar të marrë takim me të dhe rreth orës 10:45 e ka shoqëruar në Komisarariatit të Policisë Nr.2 Tiranë për shkak të kallëzimit që kishte bërë ndaj tij shtetësja I. Z., banore e një prej pallateve të administruara prej tij. Shoqërimi është bërë me makinën e ankuesit. Kur ka mbërritur në komisarariat rreth orës 11:00, ka marrë takim me inspektorin e krimeve, i cili e ka njohur me akuzën dhe i është drejtuar me fjalët: "ju jeni hajdutë; ju administratorët vidhni popullin; çfarë kërkonit ju?; Merrni lekët". Ankuesi i ka shpjeguar inspektorit të krimeve se dispononte dokumentacion sipas ligjit. Me kërkesë të këtij inspektori, ankuesi ka komunikuar në telefon me shtetasin M. N., administratorin e pallatit ku banon kallëzuesja, të cilit i ka thënë të paraqitet në komisarariat.

Në orën 11:30, ankuesi është kyçur në dhomat e shoqërimit të këtij komisarariat, ku i është bërë kontrolli personal dhe i janë hequr e marrë disa sende dhe aparati i telefonit celular. Para se të futej në dhomën e shoqërimit ai ka pasur mundësinë të njoftojë avokatin e tij. Në dhomën e shoqërimit është mbajtur edhe administratori M. N. Të dy kanë pritur

të japin shpjegime deri në orën 19:30, kur janë thirrur për t'u marrë në pyetje. Megjithëse ankuesi ka këmbëngulur që gjatë pyetjes të jetë i pranishëm avokati, kjo kërkesë nuk është pranuar me arsyetimin se ai nuk ishte i ndaluar. Procesverbalin e marrjes në pyetje e ka lexuar, e ka firmosur dhe ka kërkuar t'i jepet një kopje, por kjo kërkesë është refuzuar. Nga komisariati ka dalë bashkë me administratorin M. N. rreth orës 20:15.

Për verifikimin e pretendimeve të lartpërmendura kemi kërkuar informacion në Komisaratin e Policisë Nr.2 Tiranë me shkresën Nr.K2/I5-3 Prot., datë 28.10.2019, si dhe kemi administruar disa dokumente si më poshtë:

- formulari i raportit të shoqërimit;
- procesverbalet e veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë për shtetasit T. A. dhe M. N.;
- dy fletë të regjistrit të takimit të avokatit me të ndaluarin/arrestuarin;
- procesverbalet për marrjen e të dhënave nga shtetasit T. A. dhe M. N. në cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale;
- një fletë të Regjistrit të personave të shoqëruar;
- shkresa nr.10656/K prot., datë 21.10.2019 e Komisariatit të Policisë Nr.2 Tiranë ku i përcillen prokurorisë materiale procedurale në ngarkim të të dyshuarit T. A. për veprën penale të vetëgjyqësisë.

Në përgjigjen që morëm nga Komisarati i Policisë Nr.2 thuhet se: “avokati i shtetasve T. A. dhe M. N. është lejuar të konsultohet me klientët, por nuk ka qenë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje për arsye se ata janë pyetur si persona që kanë dijani për ngjarjen. Deklarimet janë akte procedurale dhe kopje e vetme, për këtë arsye nuk mund t'u jepet një kopje personave deklarues. Shtetasit T. A. dhe M. N. janë shprehur në *procesverbalin e veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë me personin e shoqëruar* se nuk kanë pretendime dhe ankesa në lidhje me sjelljen e policisë duke e firmosur me vullnetin e tyre të lirë”.

Pavarësisht kërkesës tonë, Komisarati i Policisë Nr.2 nuk ka dhënë shpjegime lidhur me arsyen pse nuk ka përfunduar në një kohë të shkurtër marrja në pyetje e dy shtetasve dhe nëse i janë sekuestruar atyre përkohësisht sendet personale.

Nga dokumentacioni i administruar dhe këqyrja e regjistrit të personave të shoqëruar rezulton si më poshtë vijon:

- Shtetasi T. A. është shoqëruar nga punonjësi i policisë D. L. Sipas shënimeve që ky i fundit ka lënë në formularin e raportit të shoqërimit, shtetasi T. A. është shoqëruar në datën 17.10.2019, ora 11:30, për konflikt dhe është liruar po në këtë datë, në orën 20:00. Sipas shënimit të lënë në regjistrin e personave të shoqëruar, shtetasi T. A. është shoqëruar në komisariat nga SPZ D. L., në datën 17.10.2019, ora 11:30 dhe është liruar në orën 20:00. Arsyeja e shoqërimit e shënuar në këtë regjistër është për konflikt duke referuar nenin 109/1/c të Ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Me të ka punuar oficeri i policisë gjyqësore E. Ç. Ky i fundit ka plotësuar procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar, formular që është firmosur pa pretendime nga shtetasi T. A. Në rubrikën *arsyeja e shoqërimit është shënuar*: “konflikt”. Ndërsa në rubrikën *veprime të kryera nga punonjësi i policisë* është shënuar: “deklarim i thjeshtë”.
- Shtetasi M. N. është shoqëruar nga punonjësi i policisë E. Sh. Sipas shënimeve që ky i fundit ka lënë në formularin e raportit të shoqërimit, shtetasi M. N. është shoqëruar në datën 17.10.2019, ora 12:00, pasi shtetësja I. Z. ka bërë kallëzim për të, sepse nuk e lejon të futet në garazhin pronë e saj. Sipas shënimit të lënë në regjistrin e personave të shoqëruar, shtetasi M. N. është shoqëruar në komisariat nga SPZ E. Sh., në datën 17.10.2019, ora 12:00 dhe është liruar në orën 20:00. Arsyeja e shoqërimit e shënuar në këtë regjistër

është për konflikt duke referuar nenin 109/1/c të Ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Me të ka punuar oficeri i policisë gjyqësore E. Ç. Ky i fundit ka plotësuar procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar, formularë që është firmosur pa pretendime nga shtetasi M. N. Në rubrikën *arsyeja e shoqërimit është shënuar*: konflikt. Ndërsa në rubrikën *veprime të kryera nga punonjësi i policisë* është shënuar: deklarim i thjeshtë.

- Sipas shënimeve të lëna në regjistrin e takimit të avokatëve me të ndaluarit/arrestuarit, avokati i dy shtetasve në fjalë është futur në komisariat në orën 15:10 dhe ka takuar OPGJ E. Ç. Shënim tjetër nuk është lënë.

Referuar proceverbaleve për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, OPGJ E. Ç. ka marrë deklarime nga shtetasi M. N. në orën 15:15 duke e pyetur lidhur me kallëzimin e shtetasës I. Z., e cila pretendonte se ai e kishte ndaluar të hynte në parkimin e saj privat dhe se nuk lëshonte kupon tatimor. Ndërsa shtetasi T.A. është marrë në pyetje në orën 19:00 për të njëjtat pretendime. Sqarojmë se deklaratimet e shtetasve T. A. dhe M. N. na janë vënë në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me shkresën Nr.17021/1 Prot., datë 26.12.2019.

Në përfundim të hetimit administrativ të kësaj ankese dhe pasi analizuam në tërësi materialin e administruar, rezulton se:

Për rastin e shtetasve T. A.dhe M. N. nuk janë respektuar rregullat që kanë të bëjnë si me personat e shoqëruar ashtu edhe me personat e njoftuar për t’u paraqitur në ambientet e Policisë së Shtetit. Megjithëse Komisarati i Policisë Nr.2 Tiranë shprehet se dy shtetasit janë pyetur si persona që kanë dijeni për ngjarjen dhe titulli i procesverbalit të marrjes së deklaratimeve është ai i personave që kanë dijeni për veprën penale, në fakt të dy shtetasit janë trajtuar si persona të shoqëruar. Ligji Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” bën një dallim ndërmjet personit që njoftohet për t’u paraqitur në polici dhe personit të shoqëruar, përkatësisht në nenet 108 dhe 109 të tij.

Në nenin 108 “Njoftimi për paraqitje në polici” parashikohet se:

“1. Punonjësi i policisë njofton personin për t’u paraqitur në ambientet e policisë në këto raste:

a) për të marrë informacion për parandalimin e veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm;

b) për të identifikuar personin që mund të ketë dijeni për rrezikun apo incidentin;

c) për të identifikuar shkelësin e mundshëm të ligjit.

2. Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletëthirrjes, duke përcaktuar arsyen e paraqitjes, të dhëna për punonjësin e policisë, kohën, vendin dhe informacion për ta kontaktuar punonjësin e policisë në rast pamundësie për t’u paraqitur.

3. Kur për shkak të kushteve personale dhe familjare, personi që njoftohet nuk mund të paraqitet në mjediset e policisë, punonjësi i policisë mund ta marrë këtë informacion në vendndodhjen e personit të njoftuar.

4. Në rastet kur personi i njoftuar nuk paraqitet në ambientet e policisë pa shkaqe dhe arsye të përligjura, policia kryen shoqërimin kundër vullnetit të tij, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

5. Punonjësi i policisë dokumenton në proces- verbal veprimet e kryera sipas pikës 1, të këtij neni. Procesverbali, nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i paraqitur në ambientet e policisë. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit që është paraqitur në polici.”

Ndërsa në Nenin 109 “Shoqërimi në polici” parashikohet se:

1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;

b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale;

ç) për të parandaluar kryerjen e një vepre penale;

d) kur është larguar pas kryerjes së një vepre penale;

dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;

e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent;

ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, **shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.**

3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

4. Efektivi i policisë njofton menjëherë qendrën operative për gjenealitetet e personit të shoqëruar, kur ato njihen, orën e saktë të shoqërimit dhe shkaqet e tij. Të dhënat e komunikuar nga efektivi i policisë hidhen menjëherë në sistemin elektronik të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave. **Mosrespektimi nga efektivi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.**

5. Punonjësi i policisë, dokumenton në procesverbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

6. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë eprorin e vet ose institucionin e interesuar për sqarimin e çështjes. Të dhënat e veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dokumentohen gjithashtu në regjistrat/librat që mbahen për këtë qëllim në ambientet e policisë ku është bërë shoqërimi i personit.

7. Për rastet e shoqërimit për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimin ose ekstradimin, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

8. Rregullat teknike të shoqërimit, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar në ambientet e policisë përcaktohen nga Drejtori i Policisë së Shtetit.”

Në mënyrë shumë të qartë në nenin 108 të Ligjit “Për Policinë e Shtetit” parashikohet se, një shtetas, në cilësinë e personit që ka dijeni për ngjarjen, njoftohet për t’u paraqitur në polici që të japë informacion për një shkelje të mundshme nga një person tjetër apo për ta identifikuar atë. Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletëthirrjes, duke përcaktuar arsyen e paraqitjes, të dhëna për punonjësin e policisë, kohën, vendin dhe informacion për ta kontaktuar punonjësin e policisë në rast pamundësie për t’u paraqitur. Ndërsa, sipas dokumentacionit të administruar rezulton se nga punonjësit e policisë nuk është zbatuar detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 108/2 të ligjit nr. 108/2014 për bërjen e njoftimit për paraqitje me anë të fletë thirrjes. Në kundërshtim të plotë dhe të hapur me këtë detyrimin ligjor, shtetasve T. A. dhe M. N. u është kërkuar verbalisht të paraqiten në Komisarjatin nr.2 Tiranë, ku kanë dhënë deklaratime për akuza të ngritura ndaj tyre, për fakte, nga të cilat mund të lindë përgjegjësia penale. Emrat e tyre janë shënuar në regjistrin e personave të shoqëruar si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale. Oficeri i policisë

gjqësore E. Ç. pasi ka marrë deklarime prej tyre ka referuar materialet proceduriale në prokurori, në ngarkim të shtetasit T. A., për veprën penale të vetëgjyqësisë. Kjo do të thotë se oficeri i policisë gjyqësore ka marrë të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe në këtë rast prania e mbrojtësit është e detyrueshme (neni 296/1 i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 109/3 i Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”). Edhe nëse do të pranojmë që ngarkesa në punë apo dinamika e terrenit dikton që shtetasve t’u kërkohet verbalisht të paraqiten në komisariat, në rastin e shtetasve T. A. dhe M. N. punonjësit e policisë kanë shpërdoruar besimin dhe gatishmërinë e tyre për t’ju përgjigjur thirrjes.

Përveç sa më sipër nga oficeri i policisë gjyqësore E. Ç., jo vetëm nuk është lejuar që avokati i ankuesit të jetë i pranishëm gjatë marrjes së deklaramëve atij, por ata janë mbajtur për një kohë të gjatë dhe pa arsye të përligjur në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 109/3 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” të cilin e cituam më sipër, si dhe me Procedurën Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016, respektivisht pikën V/1/2 ku parashikohet se:

“1. Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë masën e shoqërimit dhe mbajtje në mjediset e policisë një person për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin apo sqarimin e rrethanave në ngarkim të tij, por jo më shumë se 10 orë.

2. Afati 10 orësh është kufiri maksimal kohor i mbajtjes së një personi. Në rast se verifikimet e nevojshme (identifikimi dhe sqarimi i rrethanave) përfundojnë në një kohë më të shkurtër se sa është afati maksimal, oficerit të policisë i paraqiten dy mundësi:

a. Te lirojë menjëherë të shoqëruarin;

b. Të kryejë ndalimin/arrestimin e tij, në bazë të nenit 253/2 dhe nenit 251/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në gërmën “D”, pika 4.5 parashikohet se:

“Kur personi është njoftuar për paraqitje në ambientet e policisë (sipas nenit 108 të Ligjit “Për Policinë e Shtetit”) dhe pa arsye e shkaqe ligjore nuk është paraqitur.

Në këtë rast qëllimi i njoftimit dhe shoqërimit është: marrja e informacioneve që kanë të bëjnë me :

a) Parandalimin e veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm.

b) Për të identifikuar personin që mund të ketë dijeni për rrezikun apo incidentin.

c) Për të identifikuar shkelësin e mundshëm të ligjit.

Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletë-thirrjeve ose verbalisht. Nëse personi kundërshton paraqitjen pa shkaqe të arsyeshme, aplikohet shoqërimi forcërisht dhe kundër vullnetit të tij.

Pra, referuar parashikimeve të mësipërme, ndaj ankuesit nuk mund të aplikohet neni 108 i ligjit nr. 108/2014 për thirrjen e tij në polici, sepse ai nuk ndodhej në asnjërin prej tre rasteve të parashikuara në gërmat “a, b, c”, por ishte person ndaj të cilit ishte bërë një kallëzim.

Sipas dokumentacionit të administruar, T. A. është shoqëruar në komisariat në orën 11:30, është marrë në pyetje në orën 19:00 dhe është liruar në orën 20:00. Ndërsa shtetasi M. N. është paraqitur në komisariat në orën 12:00, është marrë në pyetje në orën 15:30 dhe është liruar në orën 20:00. Në përgjigjen dërguar institucionit tonë, Komisarati i Policisë Nr.2 Tiranë nuk ka dhënë ndonjë shpjegim pse nuk ka përfunduar në një kohë të shkurtër marrja në pyetje e dy të shoqëruarve dhe nëse i janë sekuestruar atyre përkohësisht sendet personale, veprim që nuk parashikohet të kryhet me personat e thirrur në cilësinë e personit që ka dijeni për ngjarjen.

Ne vlerësojmë se mbajtja e pajustificuar e shtetasve T. A. dhe M. N. në mjediset e policisë deri në kufijtë maksimal të kohës së lejuar (10 orë), jo vetëm që i privon ata nga liria, mbipopullon dhomat e shoqërimit, por krijon edhe një imazh negativ për organin e Policisë së Shtetit dhe trondit besimin e publikut tek ky organ.

Ndërkohë vlerësojmë se kontrolli personal i bërë ankuesit T. A. nga punonjësit e policisë vjen në kundërshtim me nenin 113/1 “Kontrolli i personit” të ligjit nr. 108/2014, ku parashikohet se:

“1. Punonjësi i policisë mund të kontrollojë çdo person të arrestuar ose të ndaluar, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin në fuqi:

a) për të shmangur një rrezik real dhe të çastit;

b) për objekte ose sende që mund të rrezikojnë jetën e tij ose të të tjerëve;

c) për të siguruar prova për kryerjen e veprës penale.”

Përderi sa shtetasi T. A. nuk është arrestuar apo ndaluar, nuk duhej t’i bëhej kontrolli dhe hequr sendet personale nga punonjësit e policisë.

Për sa i përket pretendimit të ankuesit se atij nuk i është dhënë një kopje e procesverbalit të marrjes në pyetje, rezulton se punonjësi i policisë ka dokumentuar në procesverbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar, i cili është nënshkruar edhe nga vetë ankuesi, detyrim që parashikohet edhe për personat e njoftuar për t’u paraqitur në komisarjat (neni 108/5 dhe 109/5 i Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”). Vlerësojmë se, personit të marrë në pyetje duhet t’i jepet edhe një kopje e deklarimeve të tij të njësuar me origjinalin, si një nga veprimet e kryera me të nga punonjësi i policisë. Theksojmë se legjislacioni nuk përcakton kufizim për dhënien e një kopjeje të këtij procesverbali.

Në lidhje me procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar, i firmosur prej tij, konstatojmë se ky procesverbal nuk është plotësuar në mënyrë të plotë dhe me saktësi pasi, në rubrikën *arsyeja e shoqërimit* është shënuar *konflikt*, ndërkohë që arsyeja e shoqërimit ka qenë marrja e deklarimeve për shkeljet e pretenduara nga një shtetase dhe në rubrikën *veprimet e kryera nga punonjësi i policisë* është shënuar *deklarim i thjeshtë*, ndërkohë që në aktet normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit nuk njihet ndonjë term ligjor “deklarim i thjeshtë”. Deklarimi në fakt u është marrë dy shtetasve në cilësinë e personit të shoqëruar si të dyshuar për një vepër penale. Edhe shënimet në *regjistrin e takimit të avokatëve me të ndaluarit/arrestuarit* nuk janë të plota. Aty është shënuar orari i hyrjes së avokatit, por nuk është shënuar orari i daljes së tij.

Duke vlerësuar misionin e Policisë së Shtetit për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike sjellim në vëmendje se kjo detyrë duhet të kryhet në përputhje me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme për respektimin e legjislacionit që ka të bëjë me procedurat e ndjekura për personat që shoqërohen në polici ose njoftohen për t’u paraqitur në polici;

2. Marrjen e masave të nevojshme për plotësimin në mënyrë të plotë dhe me saktësi të regjistrave dhe procesverbaleve që mbahen në këto raste;

3. Analizimin e këtij rasti në strukturat përgjegjëse dhe nxjerrjen e përgjegjësive ligjore ndaj punonjësve të policisë që kanë shkelur haptaz dispozitat e akteve normative e për rrjedhojë edhe të drejtat ligjore të ankuesit T. A. dhe shtetasit M. N.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi